

DOKUMENTA E MATERIALE

Dr. Prof. ALEKSANDËR XHUVANI

FJALË DHE SHPREHJE TË SHQIPES

V¹⁾

lënuem(të)-it eas.: *i ra* — = si të fikët (Lumë)

lënjëtar-i em. poterechi, shamatar.

lëpardhë-a ef., shm. -a kashtë e thatë e vënë tufë në dru të çarë dhe e ndezur ecet me të (fëmij e të mëdhenj) nëpër ara deri sa digjet krejt: *dy javë para ditës së verës çdo mbramje ndizen -a*; kashta që mbetet nëpër ara, mbasi të korren; gjerm. *Fachelzug*; frgj. (marcher aux) *flambeanx*, gr. *λαμπαδηφορία*.

lëpetun (i, e) mb. i ligët, i hollë (Veri).

lëpis fk.: *të ma* — *ë krypën në dorët* = të më bëhet urë, të më nënshfrohët.

lëpitkë-a ef. shm. -a pantofël: edhe *heqëlë-a*.

lëpizë-a ef. një farë dollapi në mur me tel përpara, ku mbahet buka; edhe *sergjen, sergji*.

lëpjetë-a ef.: *e ka gjuhën* — (për nusen që ja përpjek fjalën së vjehrrës).

lëpush-i em. bimë motake, që mbin vetiu, me fletë të mëdha e të trasha; këtej: *vesh llapush* = me veshë të mëdhej.

lëpushtë-a, lëpushtë-r-a ef.: — *duhani* —, fletë duhani (Dukagjin); *lëpushtë-r e misrit* = llapusha e misrit.

lërce-ja ef. të pëgërët, të dalët hollë, të ujshëm, të fëmisë.

lërenj fk. pushoj: *nuk lërente së qari, lëren të punojë zemra, fryma* = pushon, s'punon më; *nkë mund u lërenj shpiin* (Pj. Budi, Doktr. II 36).

lërim-i em. të punuarit, lëvrimit: *-i i tokës; -i cekët, i thellë i tokës; i bëj një — të thellë tokës; — i trupit; — i i mendjes*.

lërtoj fk. ledhatoj, përkëdhel: *me dorë e lërton*; sin. *malagoj*; krhs. FGJSH 281: *lurtoj*.

lëshesë-a ef. të lëshuarit e gruas, it. *divorzio*: *ai ja përmend gruas gjithnji -n* (Elbas.); sh. FGJSH 274 *lishesë*.

lëshohem fm. 1. shkoj në një vend: *lëshohu një çikë aty ke unë* = gjerm. *mache ein Sprung*; po *lëshohem një herë, u lëshova*; turrem, vrapoj: *do të lëshohem një herë nga shtëpia*; hidhem, derdhem mbi: *Avarët u lëshuen si të tërbuem ndër vendet tona* (Ndre Mjeda, Këndime III, 186) = it. *invasero*; *i — me vrull; u lëshuen si dhitë më krypët*; 2. *u lëshoke atij shpirtit e ja kallëzo* = it. *riconere* (Pj. Budi, Pasq. 164); *lëshohen ndë qyshdo farësh punëra të këqia* (J. Vreto, Mirëv. 47) = jepem pas, kapem mbas; *lëshohem ndë vjedhje, në punëra të liga* (ib. 47) *lëshonem ndë punëra të liga* (ib. 96); *lëshonenë ndër këto kafshë të mbrazëta* (Pj. Budi, Pasq. 68); *lëshohem mbas ndonji gjaje (mbas haes, pijes etj.)*, ose *lëshohem në një gja* = = ipem pas; frgj. *s'adonner*; 3. *lëshoj vehten, dobësohem*.

1) Përpunuar dhe pregatitur për botim nga Mahir Domi e Qemal Haxhihasani. Sh. SF 1971, 4.

lëshon fjk.: *lumi* — = vërshon

lëshoj fk. 1. liroj, e le të lirë, e le të ikë: *lëshoi izrailinjtë që i mbaninë rop*; — *viçin, (ja) — qent*; *lë: më dhimti kryet shumë shparë, por njime më lëshoi (dhimbja)*; 2. nxjerr, çel: *pema ka lëshue dega, ka lëshue rranjë; ka lëshue gjandra*; 3. jap: — *nji dhomë, një shtëpi me qera*; 4. — *nji britmë = bërtas; më lëshoi lëng goja = m'u lëngëzua*; fig. *i lëshon goja lëng*; 5. — *gojën = i përgjigjem, flas me të ashpër, me të egër*; — *gojën më ndonjë = çel gojën të flas keq për ndonjë*; 6. *nuk e — prej goje = flas gjithnjë (për diçka); nuk e — prej mentsh = e kam gjithnjë ndër mend*; 7. braktis, lë = *plakun e lëshon fuqia; atë e lëshoi zemra = u ligshua*; (Elb.) — *ndoresh nji gja = nuk kujdesem më për të, e braktis; përse më lëshove mue = (= ut quid. derelequisti me (Pj. Budi Pasq. 186); i — vendin; mësimet e asaj doktrine lëshuenë vendin një jetës së re (Ndr. Mjeda, Këng. III 184)*; 8. *e — vehten poshtë = e lë, e bëj vehten të bjerë poshtë*; 9. *për trimni shqiptari s'ja lëshon kuj (rrugën)*; || fjk. 10. *pambuku po lëshon = po lidh lule e boçe (Him.), it. boccia*; 11. *bleta lëshon = ikën, rojit*; 12.: — *mjekër = e lë mjekrën pa rruar, gjerm. liess seinen Bart stehen.*

lëshuem(të) -it cas.: *asht në të — (akëcila grue) = për lihonë, do të pjellë (Krujë).*

lëshuar(i,e) mb.: *me dorë të — = me dorë boll. me dorë plot.*

lëtirë-a ef. lidhëse kashte që përdoret për të lidhur duajt në të korrur a për të veshur me kashtë; bëhet prej kashtës së asaj bime që korret; edhe *qepsë-a*.

lëve-re-ja ef. fik i thatë i çarë për gjysë.

l(ë)vere-t efsh. veshja e bardhë, it. *biancheria*; FGJSH 269 = këmishët, ndërresat.

lëvire-ja ef. shenjë që lë mbrapa një njeri a një kafshë, kur ecën, vazhdë: *ndiqe skilen mbas -s; gjeji mbas -s lopët që të vodhën (Ndroq i Tiranës).*

lëvirem fm.: *-me gjak = lahem me gjak (Dibër).*

lëvon fjk, vlon: — *ujët (Vlorë).*

l (ë) vore-l (ë) vorja ef. cefla, lëkura: *-ja e mollës, e dardhës; e fikut*; edhe: *labë; lëkura e drurit; (Pejë) -ja e vesë; sin. zhabë, lëkurë; sh. edhe FGJSH 269 lëvore.*

lëvozhgë-a ef. mbulesa e fortë e arrës, e bajames; — *a e kështejës; — a e vesë*

lëvrihem, u lëvriva, jam lëvrirë fm. thuhet sidomos për fëmijë që fëlliqen, zhyhen, bëhen trokë (Jugë); *mos u lëvri në ujë (me ledh), në baltët = mos u lag mos u ndyj; ndragem: foshnja u lëvri = u ndrag, doli jashtë (Starovë e Porad).*

lëvrim-i em. 1. të lëvruarit, të punuarit e tokës: — *i thellë i tokës; një pendë qe sa dynym — bën në ditë*; 2. — *et kombëtare = lëvizjet kombëtare, krhs. me lëvrij — lëviz.*

lëvrij aar. *lëvrita* fjk. lëviz: *me të ecur — në këmbët e duart; yjtë — në në hapësirët; erërat e retë — në; krhs. me lëviz; mbase-r-ja është infiks, ose te lëvis ka rënë r-ja.*

lëvyrem fm. gërricem (Çermën. e Elb.); 2. lodhem: *u lëvyra — u lodha, më vrau puna (Bashk. 238).*

lgjim-i em. të folurit, ligjërim-i : — *i Elbasanit, i Tiranës etj., it. linguaggio; nga ligjërim si shllim nga shembëllim, përllim nga përlligjim etj.*

libero-liberua em. emër bualli të madh me trup (Myzeqe, A.Dani).

libë-a ef. pjatë, çini (Çamëri)

lidhëm (i), -e (e) mb. fëmijë, djalë me trup të fortë, i fortë; anton. *(i,e) qullë; frgj. fort, robuste, musculoux; sh. edhe i lidhun i lidhur.*

lidhje-lidhja ef. 1.: *lidhja e kontratës*; 2. *mbaj-shoqërore me dikë, i këpus —t me ndonjë, i kishte këputur —t me popullin etj.*

lidhun(i)-lithme (e) mb. 1. i fortë, i ngjeshur mirë: *djalë —; tokë e lithme, frgj.*

solide (Shpat i Elbas.); 2. i zënë me punë, i penguar të lëvizë: *kur asht grueja me fëmijë âsht e lithme.* dh. edhe *i lidhur i lidhun.*

lidhur (i, e) lidhun (i, e) mb. 1.: *trup i lidhur; djalë i lidhun* = i shëndoshë, frgj. *robuste*, edhe *i lidhëm; të lidhuna e të fryjme* (Pj. Budi, Pasq, 42); 2. *unë jam i lidhun* (me të) = jam anëtar i tij, mbaj anën e tij; 3. *i lidhur* (Gjirok.) = frgj. *impotent*; 4. *janë trima të lidhun* = të vendosur (edhe: *me fanë*) = it. *decisi*.

lifçer-i em. ujët që bie prej një shkëmbi poshtë me zhurmë (Bërzeshtë e Librazhdit).

ligaç-e mb. i dobët, shëndetlig (Gjirok.)

ligatë-a ef. livadh a kullosë që ka ujë gjithnjë; sh. FGJSH 271.

ligatinë-a ef. moçale, pallade; FGJSH 271 = verd ligatë, moçal.

lig(ë), - ligë(e) mb. 1. i dobët: *ka i - , lopë e -ë* (Veri); 2. që nuk i qëndron së keqes: *me atë vdekje që i ra, u kallzue -* = jo burrë (Veri); 3. i sëmurë shumë; *bahem i -* = sëmurem fort, *u bashë e -ë* = u sëmura fort; *ra i -* = u sëmur keq; (Veri); 4. i keq, i prapë: *udhë e -ë* = udhë e keqe (Jugu); *fuqia e -ë*; 5. *grua e -ë* = grua e rëndë, me barrë (Korçë).

ligem f m. 1. dobësohem nga sëmundja ose nga tjetër shkak; *qenke ligë; sa qenka ligë!*; *âsht ligë*; thahem nga fytyra, dobësohet: (Bogd. 3): *ligetë e shqimbetë..*, gr. *ἰσχοῦνω*, it. *divenir magro*, dismagrirsi; *ligtu ora* = *t'u ligtë ora* = t'u dobësoftë; 2. bie i sëmurë, sëmurem: u lig: *e u lig me vdekune ashtu për të çpejtë* (P. Budi, Pasq. 270); në disa vise (Dibër etj.) — thuhet vetëm për kafshët; 3. *më liget* = më vjen liksht, më vjen keq (Shpat i Elbasanit).

ligë(e)-a ef. sëmundje e tokës, epilepsi: *e kap ajo e -a* = ajo punë, epilepsia.

ligë(e)-a ef. 1. e keqja: *kur të gjen derën e -a, s'të dahet ma kurrë; e -a bâhet këtças* = rreziku, mënxyra bëhet menjëherë; *shëndoshë e pa të -*; *i kanë ndejtë të - at mbi krye*; *dola së ligash* = dola, shpëtova nga të këqijat; 2. e sharë, nëmë: *më marrsh të -at e shtatit, të -at kreit*; 3. *e -a e shtëpisë* = nevojtoresja; 4. *të -at* = = të dalmet (e të sëmundit)

ligës-a ef. jargë (Korçë).

ligësi-a ef. 1. dobësi, ligështi (Dibër); 2. paburrëri (Veri); 3. FGJSH 271 = cilësia e atij që është i keq; 4. punë e ligë (Jugë).

ligështi-a ef.: velani, si të fikur; *trupi ka ra në -* = është ligështuar; it. *grande indebolimento, esaurimenta*; edhe FGJSH 271.

ligështohem fm.: *u ligështue i sëmundi* = u bë më keq; iu afrua vdekjes.

ligështuar (i, e) mb.: *një popull i - prej lëngatave* = i drobitur, i vënë poshtë.

ligët (i,e) mb. 1. i dobët; 2. *tokë e-* = jo pjellore.

ligëtar,-e mb. emf. ai që bën të liga, gr. *κακοῦργος, κακοπονός*, - *pa shpirt*. (G. Meyr, Alb. Stud. V, f. 70).

ligosh,-e mb.: *ka mbetur e rrëgjuar -e si karkaleckë, këmbët e lepurit janë -e.*

ligur (i,e) mb. e kundërta e i ngjallur: *njeri -i, kafshë e-; faqe të -a* (nga sëmundja etj.).

ligje-t efsh. 1. fjalë a vjersha me rimë që thonin gratë kur qanin një të vdekur: *e qau djalin me -*; 2. *ligjë* efsh. *qaj me ligjë* = me dënesë.

lig (j)et fm.: *nëpër pluhër lig (j)en* sytë = sëmuren.

ligjohem fm.: *po hupi kau pa shej' e pa dukë, bulku do t'i ligjohet.. me be* (Kan. i L. Dukagj. 34) = do të betohet se nuk ka gisht në dam të kaut, do të justifikohet.

ligjërohem fm. kuvendoj (Elbas.)

ligjërim-i em. 1: *qaj me -e* = me ligje, gr. *μελυγμιος, μερούμιόν*;

2. FGJSH mënyra e të folurit të një vendi.

ligjëroj fjk. 1. flas: *ç'ligjëron kështu?*; 2. (Him.) *qaj me fjalë*, 3. (më, të, i) shkon fjala: *në këte shtëpi a atë katund ai ligjëron* = it. *ha voce in capitolo*; 3. *zoqtë ëmbël -në* ose *ligjirojnë*; *zogjt ligjironin*. Sh. edhe FGJSH 271.

ligjëtar-i em. njeri i ligjëvet, jurist (neologjiz.)

lihonë-a ef. 1. lehonë: *ra-*, *âsht më të ramit-*; 2. *jam me bark* - = jam esull, s'kam ngrënë gjë fare.

lijë-a lijë-a ef. këmishë (sidomos e grave); *kur e kujtoj, më dridhet lija që kam veshë* = tmërrohem; *dola linjës* = u çudita tepër, gjerm. *aus der Haut fahren*

lijosun (i,e) mb. i vrarë lije: edhe: *i lijuem*.

lijuem(i), -e (e) mb. i vrarë lije; edhe *i lijosur*.

lik ndf. tamam, pikërisht: *iu daftë toka — përmes; zjarm i ka dhanë, — përmyjet Jovanit i ka ra; i ka ra n'hutë — përmyjet = m₁ në m₂st, n'ijë, e rroku tej për ej; (Gaz, 236) i rashë malit — përpyjet = drejt përpyjetë; edhe shpatë qi na i ka ra, për gjysë njaty — ka d₁; || në lik: dymëdhetë kutë Jovanin e ka çue, në lik përmyjet e ka kputë d₂kun n'tckë; || për lik: shkoi për lik = e rrëqethi, e pshiku. Edhe, FGJSH 272.*

likatë-a ef. **likat-i** em. shm. **-a** çile pambuku, lidhje e vogël penjësh: *a ma jep një — pe; shkuli ndahet në blë, bleni ndahet në -a* (Kosovë, Tiranë); edhe *gile* (Krue), *këmbëz-a* (Korçë); sh. edhe FGJSH 272.

likëngër-i em. kurmagjak-u (arbër, e It), krh. me gr. λουκάκινο.

likoj fjk. i gjimoj, i vhem mbrapa; krhs. *nëpër lik të dheut*.

liksht ndf. keq: *e goditi — me gur; bëre — që i the; e ka — punën; bëra — që.*

likshtoj fk.: *më likshtoi zemrën* (kur u rrëzua ajo prej shkallëvet); *likshtohem: â likshtue fort vendi* (Dibër); sh. *lig(ë)shtoj*.

liktyrë-a ef. një si gjalmë i gjatë prej kashte, me të cilin lidhin duajtë e të lashtavet (Zagori e Gjirok.)

lik-u em. shm. *liq-t* dy të thururat që bën vekësi për të përshkuar mbi ta tymnin e pëlhurës (E. Ndocaj); FGJSH 273 *liq-të*.

limakosur (i,e) mb. i ziosur, i babëzitur: (i dha një copë të madhe me djathë e rrëmbëu) *e — dhe mblodhi vehten*.

limer-i em. vendi, shtroftka e hajdutit; edhe FGJSH 272

limonkë-a ef. fasule më ngjyrë të verdhë dhe me kôkrra të rrumbullakta.

lind fk. e fjk.: *kur -i djalin; ka nusen për të -ur* = nusja e saj është gati për t'u shkarkuar nga barra, do të pjellë së shpejti; *-i shpresa për një të ardhme më të mirë; lindem: fm. atëhere kur u lint djali* (Doz. 70).

lindiris fk. lë, braktis, it. *abandonnare* (arbr. e Italisë).

link(me) ndf.: *me zi mundnë të shpëtojnë duke ikur — = link thi; me shpejtësi me vrull: e marr një punë a një udhë —; punoj — (Jugë); krhs. linkthi.*

linkthi ndf. më të shpejtë, më link, me vrap: *kali ecën —; edhe njeriu ecën —* (Elbas., Vithkuq i Korçës).

linjë-a ef. çarçaf: *i vuri -en gruaja burrit* = e vuri ndër vehte burrin = gjerm. *unter den Pantofflen* (arbër. e Ital).

liparak-u em. lypës (F. Noli, Kasollja 17).

lipcar-i em. lypës.

lircë-a ef. lidhëse, e lidhme e kresë prej pëlhure (= fioccho) (Kosovë).

lirek-u em. 1. një copë prej leshi me lidhca që i vihet foshnjes në shpinë mbi shpëvqënjtë, kur e lidhin (Lumë); ndrizat me të cilat pështillet fëmija (Kosovë); 2. foshnja e lidhur në shpërngënjtë (Lumë); edhe *lurek* (Dibër), *lulak* (Kosovë), *kopanec* (Elbas.)

lirë ndf. jo shtrenjt: *e bleva-, e bleva për —; me të —: e blej një gjâ me të — = jo shtrenjt.*

lirë(të)-të cas.: *me dhanë — kamatnikëvet = liri* (Pj. Budi, Pasq. 98); *të -të e mendsë* = it. libertà (Pj. Bogdani 31).

lir(ë)si-a ef. shitje e sendeve të nevojës së parë me çmime të ulta: — *e madhe*; ant. *shtrenjtësi*.

liri-të efsh. flokët e qafës së kalit, lelet, jelet: *mos u tremb, mbahu nga - të* (Çamëri).

lirishtë-a ef. vend pa lisa në pyll, fushë e vogël e rrethuar në mes të pyllit (Polis i Elbas.); krhs. *rrog*; sh. edhe FGJSH 274.

liroj fk. 1. labërgoj diçka të shtrënguet: = *vidat e një vegle, — rrypat e këpu-cëvet, — këpucët*; 2. hek diçka nga një vend dhe e zbraz, e le të lirë këtë për t'u vendosur ndonjë send tjetër: — *nji vend, — nji tryezë; më liro udhën, më liro dritën* = = mos më zerë, mos më pengo dritën; *i — rrugë = i bëj udhë, i lëshoj udhë*; 3. pushoj: *më liroi të dhimtunit e kresë, të barkut a të ndonjë tjetër ane të trupit, më liroi pak dhimtja e kresë*. 4. ul çmimin; || *lirohet* = ulet çmimi: *u lirue tlyeri, mishi* etj.

lirshëm ndf. në mënyrë të lirë, jo shtrënguar: *ata munden me u sjellë mâ — lirtinë-a* ef. vend i çelët (në pyll) pa druj (Çermen. e Librazhdit), sh. *lirishtë*.

liruar ndf. lirshëm: *mos folë kaqë —; gjuha shqipe zuri të këndohet —*.

lireshëm ndf. lirshëm, liruar: *e lidh — për shkop*.

li-a, li-ja ef. sëmundje ngjitëse: *shënoj — në, shartoj —në, shpoj a nxjerr —në*, gjerm. *ich habe die Blätternbekommen; e ka zënë lija; i vrarë lije*.

lisa-t emsh. pjesë e avlëmendit përbërë prej dy purtekash paralele që lidhen në mes tyre me penjë në formë të lakut. (Labëri).

lisni-a ef. lisnaje, pyll me lisa: *kemi zabele e — për qymyr mjaft* (Bashk. 233); edhe FGJSH 274.

lisnik-u em. degë gjethesh ahu a dushku, të vendosura rreth një huri duke formuar një farë mullari; këtë gjeth e mbajnë për në dimër si ushqim për bagëtinë. (Korçë).

lisparth-i em. shm. *lisoperthe-t* plehu i formuar prej fletëvet të lisave ase prej të treturit të tyre: *thisë i pëlqen tepër gjumi në —; të hapish nji rrah — i bën shumë bereqet* (Sulovë e Gramshit); sh. FGJSH 274 *listopath-i*.

lisk-i ose **lisk-u** em. dash i bardhë me pikëla të kuqe në fytyrë e në këmbë, fem. *liskë-a* (Lumë).

liskë-a ef. dele me pika, plloça, të kuqe në fytyrë (ose në këmbë), sh. *lisk-i*, (Lumë); dele që e ka turirin të kuq (Mat); mb. *dele, dhi —* = me pikëla të kuqe (Lumë); krhs. *liska* slav. = një farë pate e egër.

lismë-a ef. arë që ka shumë gurë

lis-t emsh. lythet që dalin në duar.

lishakë-a ef. lisharth, shregull.

lisht ndf. keq, liksht: — *nga shëndeti* (Lumë).

lishtë(i,e) mb. i dobët (Lumë), nga *i ligshhtë*.

lit fk. takoj, prek, cik, tok: *unë e -a shkopin tënd, kur lozëm larashazi dhe të futa një cetëzë* (Myz., A. Dani).

litar-i em. 1.: *âsht e gjatë (nji punë) — kali*; 2. *ata të lëshojnë -in nëpër kambë* = të qisin ngatërresa; 3. *kam -in në fyt* = jam shumë keq, në një gjendje s'ka më të vështirë: *sikur kam -in në fyt*; 4. *na u mblodh -i* = po i afrohem fundit të një pune a gjëje, po mbarohen ditët e një pune; edhe: po na shkon jeta, po i afrohem fundit të saj.

litër-a ef. çile leshi që bëhet duke e mbledhur nga jomaku te gjunjët (Shpat i Elbas.); fijet e lirit të mbledhura në këmbëz (Berat); shumë fiye të lirta ase të leshta tok në qerth (Myzeqe).

litërkë-a ef. çile pambuku (Shpat i Elbas.)

litrak mb. : *ka —* = ka që nuk është tredhur mirë, gjysëm i tredhur; edhe *zorrak*, (Kavajë) *lakoç*; sh. te Gaz. 231 fjalën *latrak*.

lithar-i em. dervishët që lëshon arra; edhe *rreshte, rrezhde*.

liq-i em. e drejtë: *kërkoi -në e ti; ke —* = ke të drejtë; *me të gjithë — e pësova* =

= me shumë të drejtë, plotësisht me të drejtë; *pa -*, *pa të drejtë* (arbëresh. e Greqisë).

liç-i em. *lik.-u*, rrafshi: *guri a plumbi shkoi për -t dheut; kosa duke prerë shkonte për -t dheut.*

liç-i em. 1. koka e kaut (Myzeqe); 2. qerà, rrozë, qesim kau për një vit; *zura një ka me - = frgj. condition, stipulation* (Skrapar); *i jap qetë me - = me qesim* (Sulovë e Gramshit).

liqshtoj fk. **liqshtohem** fm.: *detarët filluen me u liqshtue = filluan të kenë frikë, të humbin kurajën* (Ndre Mjeda, Kënd. III, 198); sh. *ligshthohem, likshtoj e likshtohem.*

liç-t emsh. lisat ku futen fijet e avlëmendit (Tiranë); sh. FGJSH 273.

livar fk.: - *kokën = var kokën* (Dibër)

livar-i, vlar-i, lëvar-i em. dy a më shumë vasha rrushi të lidhur bashkë për t'i ruajtur për dimër; ridofta nga *l + var = gja e varun.*

livrim-i em. lëvizje: *motorët i japin - atij me ecë; - in e makinavet, e ban një motcr;* sh. *lëvrij.*

lizgë-a ef. dhe argjil (Devolli)

lizmë-a ef. verd i rjepur me baltë të bardhë, më tepër anës përrenjvet, që nuk bën për kullotë; (Liboh.) verd me pak ujë ku shket njeriu, si rrëke etj., krhs. greq. γλυστραίνω; ; (Gjirok.) tokë e pjerrët, zakonisht me një baltë që i afrohet shtufit e që bëhet copëra copëra; mbi të lozin fëmijët duke rrëshqitur në një pafille.

lkitër-a ketërr (Martanesh i Matit, Mat)

lkoqun (i,e) mb.: *rrugë e - = rrugë e shtruar me kok rra gurësh, me copa gurësh.*

lkojë-a ef. moçal (Mirditë, Lumë); edhe *latërr, kllaçe-ja.*

lkyhem fm. (ndërtohet me dhanoren): *i - = i gjimoj, i pilohem* (dikujt) (Veri).

lmazë-a ef. lëkurë e hollë (Shkod.); sh. FGJSH 267 *lëmazë.*

lmekët (i,e) mb.: *petka të -a = pak të lagëta, të rita, të mekëta, të ritueme;* krhs- FGJSH 303 (i,e) *nekët; mektcj: = lag, njom.*

lmetur (i,e) mb.: *rrobe të -a = të pathara mirë* (Devolli), sh. *lmekur (i,e).*

lmuç r.df. : *ra - = grumbull, shuk; u rrëxue prej së nalti e ra në vend -; e rrxoi - për tokë; edhe palmuç;* sh. edhe FGJSH 268 *lëmuç.*

lmuth-i em. sumbulla, birma e lisit (Vërçë e Gramsh.), konxhe e lules së blirit (Shtërmen i Shpatit të Elbas.)

lmujshk-u em. myshku që vesh tringun e lisit; krhs. Gaz. 237 *lmashk-u.*

lnur fk.: *-leshin = e kreh, e bëj me shutra; lnurem* fm. - *petkash = grisem keq nga petkat* (Lumë), edhe *leskarohem*, sh. Bashk. 235; sh. edhe FGJSH 268, 275 *lënur* dhe *lnur.*

lnurem fm. grisem petkash, laskarohem petkash.

lobiçe-t efsh. hijet, luçetrit; krhs. *ubi-ja.*

lodër-lodra ef. : *iu bâ barku - = iu fry barku prej të ngrënit;* krhs. : *m'u bâ barku bucelë* (Veri).

lodër-a ef. lopa (Shkrel i Shkodrës).

lodërta-a ef. 1. kodër (Shkod.), edhe *tupan;* 2. shm. -*të = aheng; u bien - vet* (Pj. Bogdani 56) = *u bien sazevet, it. suonano gli strumenti.*

lodrak-u, lodrake-ja mb. em. lozanjar-i e lozonjare-ja, që i pëlqejnë lodrat, nazet.

lodroj fjk. loz, luaj; *-në fëmijët; - qent shoq me shoq.*

lodh fk.: *a thue mos të ka -ë rruga? e kanë -ë ethet shumë; e ka -ë dhimba; po - te mendjen = po preokupohej; || lodhem* fm.: *fort kenka lodhë = qenka lodhur shumë, qenka i këputur, it. abbattuto; nuk i lodhet mendja atij; u lodhshë* (Tir.).

lodhëm (i), lothme (e) mb. i lodhur: *jam e lothme*

lodhët ndf.: *jam - = jam i lodhur*

lodhët (të) - it cas. lodhje, të lodhur: zemërzest s'kanë të - pse rrâjnë.

lodhnim-i em. lihonja, koha e lihonisë (Malësi e Shkodrës)

lodhshëm ndf.: *jam - = jam i lodhur*

lodhur (i,e) mb.: *i - nga uria = i vënë poshtë nga..*

lofë-a ef. **lofkë-a** ef. vendi ku qëndron zemra; zemra: *oj lof'e ime* oj zemra
jme (Martan. i Matit).

logori-a ef. vaje, ligje: *qaj me vaj e me - , qaj me - e me ligje*; edhe FGJSH 275.

logoris fjk. vajtoj, qaj (një të vdekur): *qaj e -*; sh. edhe FGJSH 275.

logoj fk. sheshoj, rrëfshoj një verd që është gropa gropa, duke i mbushur
gropat (Veri), Gaz. 238; sh. edhe FGJSH 275.

log-u em. verd rrëfsh (Veri); Gaz. 238.

lojë-a ef. grua e bukur nga trupi (Elbas.)

Lojc-e mb. i paqëndruar, që s'qëndron rë fjalë: *mos i beso atij, asht-; nuk
âsht i qëndruar sh'm, por - (Bashk. 286), it. inconstante*; edhe *lojs* (Lumë), nga *lojtës*;
krhs. *bisht-li ejës = i pangultë*.

loke-ja ef. 1) nëna e babcës; 2) grua plakë; krhs. me *lok-u*; sh. edhe FGJSH 276

lole mb.: *-burrë = pa trup*; FGJSH 276 = budallë, sylesh, edhe *lolo*.

loli-a ef.: *bëhem- = bëhem gazi i botës; ata janë qeshur dhe bërë - (J. Vreto,
Mirëvet. 62)*; krhs. *i tha -të* (Elb.); sh. edhe FGJSH 276.

lopatë-a ef.: *nuk i merr -a ujë = nuk i shkon fjala; nuk i muer -a ujë = s'i
eci fjala, nuk ia erriti qëllimit që kishte vënë.*

lopatëz-a ef. fërterëz, gangër, frgj. *têtard*; sh. edhe FGJSH 276.

lopçar-i em. lopar-i

lopërinë-a ef. lopë, dema, qe bashkë (Shpat i Elbas.); FGJSH 276 *lopërina-t*
efsh. = lopë e qe, gjedha.

lopërisht ndf. lopthi, në mënyrën e bagëtive, it. *alla pecorina* (Gjir.).

lopti ndf. lopërisht, si bagëtitë (Gjirok.)

lopur (i, e) mb. i lopërt, prej lope: *qumësht të* (Gjir.)

lor-i, luar-lori em. ai që vjen e mbledh lopët për t'i kullotur, lopar, bari lo -
pësh (Gjirok.)

lorzë-a ef. kitër; sh. Gaz 238 *lozër-a*; (Çerëm)

losës-i em. ai që luan një lojë, lojtar: *- i një lodre* (J. Vreto, Mirëvet. 46),
- it e të tilla lodrave (ib).

lostë-a ef., shm. *-a-t* bërsi-a; kokrrat e rrushit (a të ullirit), kur shtypen a kur
i shtien në kade për të bërë verë (a vaj) (Vuno e Him., Q. Haxhihasani)

lot-i em. shm. *- ë: rrukullisen-ët porsi pikat e shiut kokërrmadh; i rrukullistin
- sun.bulla-sun.bulla*; dhe: *- ët i vinin breshër, lott rrëke i shkojin, lottë i vanë rrëke;
qante me shtatë palë-*; (Lumë) *nji kpujë - = një kokërr e madhe loti; qielli lot e
qielli m'lot = i kthjellët; lot-ja: si lotja qielli = i kthjellët.*

lotoj fjk. 1. *- me lot = qaj me lot; - = lëshoj lot* (Anonimi i Elbas.); 2.
*loton = pikon: gjaku syve t'loton, gjaku syve kur t'jet tue t'lotue, gjaku sysh asht
tue t'lotue*; 3 *loton hardhia = pikon, qan. // lotohem fm. = nxierr lot, derdh lot:
u lotue.*

loze-ja ef. organe të holla e të gjata të bimës që përdridhen rreth trupave të
huaj, frgj. *villë*; sh. FGJSH 276.

lozë-a ef. bishti i kungullit, sllav. (Lumë).

lozonjar-i, -e-ja mb. 1. ai, ajo, të cilit a së cilës i pëlqejnë lodrat, lëvizjet, nazet;
dhe: *lodrak-u, ludrake-ja; vala-e* (e detit) *përkëdhelet e fërkohet pas brigjeve shkëm-
orë*; 2. i paqëndrueshëm, lojc, lojtës, it. *instabile*; 3. *- e = bishtëpërdredhur.*

lpe-ja ef. mjegull e hollë afër tokës; mjegull; sh. Bashk. 236, Gaz 239; FGJSH 277.

lpizë-a ef. sergjen, dërrasë e gjatë e vënë rrëzë murit për të vendosur në të enë a diçka tjetër; sin. *streth-i*; sh. FGJSH 268 *lëpizë*.

lpozë-a ef. dërrasat që vihen mbi oxhakt për të mos u djegur.

lpungë-a lplungë-a, lpjungë-a ef. plaçkë leshi katërkëndëshe, me balçe në çdo skaj, që përdoret, në vend të bohçes, për të mbledhur plaçka; copë e madhe prej zhguni të parrahur, katërkëndëshe, me krahea për të bajtur fëmijtë, kur shkohet në gjini, vihet mbrenda foshnja, hidhet në krah a mbahet në shpinë (Mertur i Tropojës), krhs. Gaz. 239 *lplangë*; FGJSH 268 *lëplungë* e 332 *naplungë* = napë e djathit.

lputë-a ef.: - *e veshit* = pjesa e veshit përjashta; edhe *lpushtër*.